REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 11 prot

Tepelenë, më 30. 09.2026

PROCES-VERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot më **30.09.2026**, në orën **11:00**, në **Pallatit të Kulturës, Tepelenë (kati i dytë)**, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Tepelenë.

Në momentin e hapjes së mbledhjes ishin të pranishëm këshilltarët: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Latif Kaçaj, Marios Jorgo, Matilda Çela, Ditar Hodaj, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili.**

Përfaqësues të administratës së Bashkisë Tepelenë: **z. Spiro Kora, znj.Festime Elezi, z.Pellumb Hoxha, z.Adi Velaj, znj.Rovena Mullara.**

Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Arben Gumeni; Përshendetje, fillojmë mbledhjen e radhës me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes datë 28.08.2026.
3. **Projektvendim:** "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Gusht 2026."
4. **Projektvendim**: "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Gusht 2026."
5. **Projektvendim**: "Për shprehjen e dakortësisë/mosdakortësisë së Keshillit Bashkiak Tepelenë mbi projektligjin "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".
6. **Projektvendim**: "Për miratimin e raportit të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të buxhetit për periudhën Janar- Gusht 2026."
7. **Projektvendim**: "Për disa ndryshime në buxhetin e Bashkisë Tepelenë për vitin 2026.''
8. **Projektvendim**: "Për miratimin e transferimit të aseteve të infrastrukturës së Ujësjellësit pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.A."
9. Informacin nga sektori emergjencave civile mbi përballimin e emergjencave gjatë periudhës Janar–Shtator 2026 dhe masat e marra për përballimin e emergjencave gjatë vitit 2027."

10. Raport i Drejtorisë së Shërbimeve Publike mbi ndërhyrjet e realizuara për mirëmbajtjen e aseteve dhe objekteve, përmirësimin e infrastrukturës publike, si dhe punët në proces.
11. Çështje të tjera.
12. Trajtimi i ankesë, kërkesave të qytetarëve.

.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Pika e pare e rendit te dites; Jeni dakort me rendin e dites, ta hedhim ne votim .

Vota Pro 14: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Latif Kaçaj, Marios Jorgo, Matilda Çela, Ditar Hodaj, Mjaftoni Zeraj, Marsela balili** Vota kundër: S'ka,Vota abstenim: S'ka

Pika e dyte e rendit të dites; Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së radhës datë 28.08.2026. Jeni dakort, ta hedhim në votim.

Vota Pro 14: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Latif Kaçaj, Marios Jorgo, Matilda Çela, Ditar Hodaj, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili** Vota kundër: S'ka,Vota abstenim: S'ka

Projektvendim: "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Gusht 2026."

Fjalën e mori znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit për Ekonominë dhe Financat:

Komisioni u mblodh dje diskutoi kete pvendim, nuk ka ndryshime nga muaji i kaluar jane 10 familje që trajtohen me nje fond 46.531 leke , ftoj anëtaret e këshillit ta votojnë këte pvendim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Ka pyetje për këtë pikë? Ta hedhim ne votim.

Vota Pro 14: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Latif Kaçaj, Marios Jorgo, Matilda Çela, Ditar Hodaj, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili.**Vota kundër: S'ka,Vota abstenim: S'ka

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Projektvendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Gusht 2026."

Fjalën e mori znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit për Ekonominë dhe Financat:

Për dhënien e ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë janë 94 familje me fond 248.178 lekë, janë shtuar 4 familje, 2 në njësinë Qendër, 1 nga njësia Kurvelesh dhe 1 nga njësia Qytet. Ju ftojmë ta votojmë këtë projektvendim pasi janë famije në nevojë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Ka pyetje për këtë pikë? Ta hedhim në votim.

Vota Pro 14: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Latif Kaçaj, Marios Jorgo, Matilda Çela, Ditar Hodaj, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili.** Vota kundër: S'ka,Vota abstenim: S'ka.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Projektvendim: Për shprehjen e dakortësisë/mosdakortësisë së Keshillit Bashkiak Tepelenë mbi projektligjin "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

Relacionin mbi dëgjesat publike e keni përpara të zhvilluara në njësitë administrative. Për këtë projektvendim para se të shpreheni dua t'ju informojë se na ka ardhur një shkresë nga Kuvendi i Shqipërise për dëgjesa publike dhe për marrjen e mendimit të qytetarëve. Ne këtu duhet të shprehim mendimin si qytetarë pa u ndikuar politikisht. Tepelena një rreth ka qenë me qytetin Memaliaj. Sa më e madhe të jetë njësia, aq më e fortë bëhet, më shumë buxhet, më shumë investime. Secili nga ju të shpreh mendimin e tij dhe në fund do votohet. Fjalën e merr Kryetarja e Komisionit për dëgjesat publike.

Znj.Mjaftoni Zëraj: Përshëndetje të nderuar këshilltarë, jemi mbledhur për të diskutuar mbi dëgjesat publike të zhvilluara në 3 njësit administrative. Relacionin e keni përpara. Unë e diskutova dhe me Komisionin e Ligjeve, me Kryetar Ditar Hodaj dhe anëtarët Ilir Haska dhe Miftar Meta. Të tre dëgjesat publike u kryen në rregull, janë të dokumentuara të gjitha mendimet e qytetarëve, pro, kundër apo abstenim, dhe kërkësat, ankesat e qytetarëve, sidomos të zonave rurale. Unë ja jap fjalën Kryetarit të Komisionit të Ligjeve z.Ditar Hodaj, ku 2 ishin pro dhe 1 kundër këtij projektvendimi.

Z.Ditar Hodaj : Unë personalisht isha kundër dëgjesave publike në Këshill Bashkiak, pasi dëgjesa publike është bërë në qark, është shkelur Vendimi i Këshillit Bashkiak i mbledhjes datë 28.08.2026, në të cilin u vendos që do bëhej vetëm një dëgjesë. Në këto konsultime publike morën pjesë rreth 140 persona, votimi përfundimtar i komisionit, 2 vota pro, 1 kundër.

Dino Selimi : Unë si anëtarë këshilli jam pro reformës, kam marr pjesë në 2 dëgjesa, kemi dëgjuar mendimet e qytetarëve dhe çdo qytetar ka të drejtë të jap mendimin e tij. Unë jam pro këtij projektvendimi.

Z.Latif Kaçaj : Edhe unë si anëtar këshilli dhe si përfaqësues i këshillit në zonën e Lopësit jam dakort me këtë projektvendim. Në bazë të dëgjesave me komunitetin ishin dakort për bashkimin. Këtu jemi për interesat e komunitetit.

Z.Vladimir Bakiaj : Nuk jam dakort për bashkimin, kundër reformës. Nuk ka për të qenë një reformë e frytshme. Se si do jetë kjo reformë e dinë qytetarët, ju e patë sa njerëz kishte në dëgjesa, ju erdhën rreth 140 veta. Kaq është komuniteti i Tepelenës? Në dëgjesë shumica ishin punonjësit e bashkisë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Ata janë qytetarë të Bashkisë Tepelenë.

Z.Ditar Hodaj : Tre arsyet pse nuk duhej kaluar në këshill bashkiak unë i thashë më lartë, nuk jam dakort me këtë reformë, jam kundër bashkimit të Bashkisë Tepelenë me Bashkinë Memaliaj sepse është provuar më së miri me reformën territoriale të vitit 2015 me mbylljen e komunave në vend u mbyllën shumë institucione, prokurori, gjykata, hipotek etj, dhe me këtë decentralizim do mbyllen dhe institucione të tjera, sepse do ulet numri i popullsisë, numri i lindjeve dhe i martesave, po bie numri i nxënësve dhe po rritet dukshëm mosha e tretë. Pse po e bëni këtë, për të larguar njerëzit? Mbas shumë kohësh nuk do të ketë as njerëz për të punuar, mua më duket si një proces elektoral. Ndaj ju këshilltar zhvishuni nga forca e kartonit, mendoni për çdo qytetarë të dy bashkive dhe për veten tuaj. Mos e jepni dakortësinë për bashkimin përpara se të jetë shumë vonë. Çdo politikan i çdo ngjyre, apo çdo qeverisje e çdo lloj ngjyre duhet të jetë më tepër sociale, duke sakrifikuar edhe buxhet të majmë për të mbajtur gjallë qytetarët në territorin e këtyre bashkive. Unë jam kundër.

Z.Besnika Maça : Ne nuk jemi këtu për mendim partiak. Ne jemi të ndërgjegjshëm se çfarë ishin komunat, nuk kishte në fshatra as ndriçim, as pastrim dhe as gjelbërim, nuk kishte investim. Bashkimi me bashkinë e madhe ne e shikojme se çfarë është bërë, më shumë investime, më shumë zhvillim. Sa më e madhe bashkia, aq më shumë investime dhe buxhet më i madh. Jam pro bashkimit.

Znj.Matilda Çela : Sipas ligjit Nr.139/2015 Për Vetqeverisjen Vendore, kur ka ndryshim kufinjsh pyetet vetëm popullsia që banon në ata kufinj. Ne si Bashki Tepelenë mirë na bëhet, por ky projektvendim duhet të ishte për qytetarët e Bashkisë Memaliaj.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Ka pyetje të tjera ? Jo. Ta hedhim në votim.

Vota Pro 11: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Latif Kaçaj, Matilda Çela, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili.** Vota kundër: 3,Vota abstenim: S'ka.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Projektvendim: "Për miratimin e raportit të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të buxhetit për periudhën Janar- Gusht 2026."

Fjalën e mori znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit për Ekonominë dhe Financat: Për raportin e monitorimit të buxhetit, janar-gusht 2026, Komisioni i Ekonomise dhe Financave shqyrtoi projektvendimin për miratimin e raportit të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të buxhetit të Bashkisë Tepelenë për periudhën janar-gusht 2026. Deri në fund të gushtit, të ardhurat vendore janë realizuar nü shumën 39,7 milionë lekë, ose 56,66% e planit për te gjithë vitin 2026. Meqenëse kanë kaluar tetë nga dymbëdhjete muajt e vitit, ky realizim është nën ritmin kohor prej 66,67%. Shpenzimet e përgjithshme janë realizuar në masen 64,81% te planit vjetor, ndërsa investimet në masen 36,28%. Komisioni vlereson se gjatë muajve të mbetur të vitit duhet të rriten arketimi i të ardhurave, të ndiqet realizimi i investimeve dhe të kontrollohet shlyerja e detyrimeve të prapambetura.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Ka pyetje? Jo. Hidhet në votim.

Vota Pro 14: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Latif Kaçaj, Marios Jorgo, Matilda Çela, Ditar Hodaj, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili.** Vota kundër: S'ka,Vota abstenim: S'ka.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Projektvendim: "Për disa ndryshime në buxhetin e Bashkisë Tepelenë për vitin 2026.''

Fjalën e mori znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit për Ekonominë dhe Financat: Komisioni i Ekonomise dhe Finances shqyrtoi projektvendimin per disa ndryshime në buxhetin e Bashkisë Tepelene per vitin 2026, së bashku me relacionin dhe tabelën perkatese të ndryshimeve. Projektvendimi parashikon rialokimin e 9.731.000 lekëve: shtesat dhe pakesimet janë ne te njëjtën vlerë, ndaj totali i buxhetit nuk ndryshon. Brenda kësaj shume perfshihet planifikimi në vitin 2026 i 2.500.000 lekëve për kontratën e karburantit, të parashikuara fillimisht për vitin 2027. Nevoja argumentohet edhe me rritjen e theksuar të çmimit të naftës dhe me vijimësinë e sherbimeve në territor, pa ndryshuar marzhin e fitimit të operatorit ekonomik sipas kontratës dhe pa rritur vlerën totale të saj. Komisioni u njoh edhe me rialokimet prej 3.500.000 lekësh në

shtesë dhe po aq në pakësim, të miratuara me Urdhrin e Kryetarit nr. 114, datë 14.09.2026. Ato i paraqiten Këshillit vetëm për dijeni dhe nuk logariten sërish ne shumën që kërkohet të miratohet. Komisioni vlerëson veçanërisht mbështetjen prej 400.000 lekësh për grupmoshat e Futboll Klub Tepelena, ku 270.000 lekë do të shërbejne për tre trajnerë dhe 130.000 lekë për analiza e vizita mjekësore të fëmijëve. Po ashtu, projektvendimi parashikon deri në 500.000 lekë për individët dhe familjet në kushte të vështira ekonomike, sociale ose shëndetesore, pas verifikimit të çdo rasti.

Vladimir Bakiaj : Në lidhje me shpenzimet, kjo pagesë është për këtë muaj apo për gjithë vitin?

Spiro Kora : Për pjesën e mbetur deri në fund të vitit. Për zhvillimin e sportit te fëmijët, propozohet 400.000 lekë për grupmoshat e Futboll Klub Tepelena: 270.000 lekë për pagesën e tre trajnerëve gjatë periudhës tetor–dhjetor 2026 dhe 130.000 lekë për analiza e vizita mjekësore. Kjo mbështetje synon edhe shmangien e pagesave të familjeve për stërvitjen e fëmijëve. Për individët dhe familjet në kushte të vështira ekonomike, sociale ose shëndetësore parashikohet fond deri në 500.000 lekë, me përfitues që përcaktohen pas verifikimit të rasteve. Pasi bëm një analizë të hollësishme dhe të gjendjes së Futboll Klub Tepelena, u vendos nga administrata e bashkisë sponsorizimi i grupmoshave, dhe sikur të çedojmë pak tek ekipi i madh, do fokusohemi edhe në buxhetin e vitit 2027. Duke parë edhe disa mundësi lehtësuese edhe për prindërit, për t'i stimuluar dhe fëmijët për t'i larguar nga veset, nga kompjuterat etj.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Hidhet në votim.

Vota Pro 14: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Latif Kaçaj, Marios Jorgo, Matilda Çela, Ditar Hodaj, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili.** Vota kundër: S'ka,Vota abstenim: S'ka.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Projektvendim: "Për miratimin e transferimit të aseteve të infrastrukturës së Ujësjellësit pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.A."

Fjalën e mori z. Spiro Kora: Ky material është diskutuar edhe njëherë në Këshillin Bashkiak. Ju do të jepni vetëm autorizimin për kryerjen e këtij veprimi, i cili është një veprim i ndërthurur dhe teknik, ekonomik dhe financiar. Të gjitha investimet që do transferohen, që janë përfunduar

dhe janë në shfrytëzim nga Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime SH.A, është audituar nga KLSH, për të cilin do sjell material kur të vijë raporti përfundimtar i KLSH. Të gjitha detyrimet kontraktuale të firmave, detyrimet ndaj bashkisë, garancia e punimeve do mbeten përsëri një e drejtë e Bashkisë Tepelenë. Ne do transferojmë vetëm pjesën teknike dhe financiare, dhe do ta pasqyrojmë në regjistrat konstabël. Akti i dorëzimit do të bëhet nëpërmjet Kryetarit të Bashkisë dhe Administratorit të Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime SH.A.

Z.Vladimir Bakiaj: Janë hequr ato objektet e papërfunduara? Janë prap në këtë listë që do miratojmë sot?

Z.Spiro Kora: Këtë transferim që kemi paraqitur ka të bëjë me objekte tërësisht të përfunduara. Ka diskutim Ujësjellësi Dhëmblan-Sinanaj dhe Peshtan-Mezhgoran, për të cilat deri ne në këtë fazë janë të përfunduara. Ne bëjmë transferimin fizik dhe dokumentar, të gjitha detyrimet kontraktuale mbeten detyrim i Bashkisë Tepelenë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Ka pyetje? Hidhet në votim.

Vota Pro 11: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Latif Kaçaj, Matilda Çela, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili.** Vota kundër: S'ka, Vota abstenim: 3vota.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Informacin nga sektori emergjencave civile mbi përballimin e emergjencave gjatë periudhës Janar–Shtator 2026 dhe masat e marra për përballimin e emergjencave gjatë vitit 2027." Ta lexoj informacionin?

Këshilllarët; Jemi njohur me informacionin, nuk kemi pyetje.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Pika 10 e rendit të ditës; Raport i Drejtorisë së Shërbimeve Publike mbi ndërhyrjet e realizuara për mirëmbajtjen e aseteve dhe objekteve, përmirësimin e infrastrukturës publike, si dhe punët në proces.

Të lexohet raporti nga drejtori?

Z.Ditar Hodaj; Në varrezat e dëshmorëve në fshatin Progonat, të hiqet godina afër varrezave.

Z.Vladimir Bakiaj; Drejtorit ti jepen me shumë kopetenca në lidhje me shërbimet që kryhen.

Znj.Matilda Çela; Relacioni i paraqitur nga drejtoria ishte i plotë, në qytet mund të duhen vetem 5ose 6 stola.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Përpara se të kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës ju bëj me dije se në mbledhje është e pranishme një përfaqësi e banorëve të fshatit Dukaj, të cilët kanë paraqitur pranë Këshillit Bashkiak një kërkesë lidhur me tokat e përfituara në bazë të Ligjit nr. 7501. Kërkesën e paraqitur nga përfaqësuesit e fshatit Dukaj po e lexoj si më poshtë:

Kryesia e fshatit Dukaj ka marr ftesën per konsultim publik nr.2608 prot. date 14.09.2026 nga Bashkia Tepelenë per procedurën e qiradhënies së tokave bujqësore të pandarë në fshatin Dukaj, Njësia Administrative Qendër Tepelenë/ Bashkia Tepelenë për pasurinë nr.495/3 ZK3661 me sipërfaqe 23 ha, e cila ndodhet në vendin e quajtur Sheshi i Fierit, tokë e fshatit Dukaj.
Fshati Dukaj një pjesë e familjeve të këtij fshati ka marrë tokë bujqësore ne Sheshin e Fierit në pronësi të ligjit 7501 dhe këta familjarë nuk kanë marrë certifikatë pronësie por janë të paisur vetëm me tapi, për këtë kërkojmë të paisen të gjithë ata që kanë tapi në Sheshin e Fierit me Çertifikate pronësie. Duke qenë se nuk kemi harta për tokën e ndarë dhe topografet nuk na e marrin përsipër për të bërë harta për secilën familje po duhet të bëhet për të gjithe fshatin dhe shumica e familjeve janë larguar apo kryefamiljari nuk jeton më dhe duhet të bëhen dokumentet e trashëgimisë, na duhet kohë dhe ndihmë e institucioneve shtetërore për përfundimin e procesit të regjistrimit të tapive tona në hipotekë.
Dhe së dyti kërkojmë që cdo hapësirë toke bujqësore apo kullotë ne Fshatin Dükaj tju jepet me qera vetëm fshtarëve Dukjotë gjithmonë në bazë të ligjit ,kërkojmë në mënyrë kategorike mos tju jepet me qera pronarëve të huaj jashtë fshatit por tju jepet vendasve.
Për këtë arsye kërkojmë pezullimin e procedurës së qirasë dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak për dhënien me qira të kësaj pasurie deri në zgjidhjen e kësaj situate për regjistrimin e tokës private të cilën banorët e fshatit Dukaj e kanë me tapi. Për dhënien e tokave me qira deri në një afat trevjeçar, kompetenca është e Bashkisë dhe çështja nuk kalon për miratim në Këshillin Bashkiak. Për afate më të gjata se tre vjet, çështja i paraqitet për shqyrtim dhe miratim Këshillit Bashkiak. Deri tani ne nuk kemi dhënë me qira toka bujqësore, ndërsa janë dhënë me qira sipërfaqe kullotash. Në rastet kur nga banorët e fshatit paraqiten ankesa lidhur me dhënien me qira të tokave, kërkohet mendimi i kryetarit të fshatit dhe i administratorit të njësisë administrative. Në rastet kur për një sipërfaqe kullote ka konflikt apo kundërshtime nga banorët,

zhvillohet dëgjesë publike për të marrë në konsideratë qëndrimin e komunitetit. Sa i përket pajisjes me tapi të tokave, kjo nuk është kompetencë e Këshillit Bashkiak. Për këtë çështje, ju lutem të komunikoni me Bashkinë, ku do t'ju informojnë lidhur me procedurën që duhet të ndiqni.

Z.Ditar Hodaj; Tapitë janë në kadastër.

Banorë fshati Dukaj; Ajo është tokë bujqësorë nuk është kullotë, nuk është e ndarë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Ne nuk kemi dhënë me qira toka bujqësore. Në rast se do të paraqitet një kërkesë për dhënien me qira të tokës bujqësore, e shoqëruar me një plan biznesi, çështja do të shqyrtohet sipas procedurave përkatëse. Kur nuk ka konflikt dhe kërkesa për dhënien me qira të tokës paraqitet nga një banor i fshatit, merret dhe mendimi i kryetarit të fshatit dhe i administratorit të njësisë administrative.Në rast se ka konflikt apo kundërshtime nga banorët e fshatit, toka nuk jepet me qira pa u zhvilluar më parë konsultimi publik me komunitetin. Për sa i përket afatit të qirasë, për periudha deri në tre vjet kompetenca është e Bashkisë, ndërsa për periudha mbi tre vjet çështja i paraqitet për shqyrtim dhe miratim Këshillit Bashkiak. Këshilli Bashkiak, në rastet kur ka konflikt apo kundërshtime nga komuniteti, zhvillohet konsultim publik përpara marrjes së vendimit.

Z.Dita Hodaj: Po nëse kjo tokë nuk ka pronar, nëse është pronë shtetërore, shteti vepron sipas kompetencave të tij?

Kryetari fshatit Dukaj; Kjo është toke bujqësore me ligjin 7501, është tokë e fshatit të ndahet për fshatatët, është ndarë, po nuk është ndarë e gjitha, është një pjesë e pandarë.

Znj.Mjaftoni Zeraj: Nëse ju e keni të plotësuar sipërfaqen e tokës në përputhje me frymën dhe sasinë e tokës që është ndarë për gjithë fshatin Dukaj, atëherë nuk keni të drejtë të kërkoni sipërfaqe të tjera. Nëse ka familje që nuk e janë plotësuar me sipërfaqen që u takon, atyre u lind e drejta ligjore për ta kërkuar. Nëse ka persona që e kanë zaptuar tokën në kundërshtim me ligjin, që nuk janë banorë të fshatit apo janë larguar prej tij, atëherë banorët e fshatit kanë të drejtë ta kërkojnë, në mënyrë që çështja të shqyrtohet në përputhje me ligjin.

Z.Myrdar Jera: Bëhet fjalë për tokën në fshatin Dukaj, në vendin e quajtur Sheshi i Fierit. Në këtë sipërfaqe janë gjithsej rreth 23 ha tokë bujqësore, nga të cilat janë ndarë rreth 12 ha, bëhet fjalë për pjesën e mbetur, rreth 13 ha, ku ka shumë familje të fshatit që nuk janë plotësuar me tokë bujqësore, dhe mund ta përfitojnë këtë pjesë. Për këtë sipërfaqe është paraqitur një kërkesë nga një person nga Vlora, me qëllim zhvillimin e një biznesi. Ne si banorë të fshatit Dukaj, nuk e kemi pranuar këtë kërkesë. Në dëgjesën publike të zhvilluar në fshatin Dukaj, banorët janë shprehur se nuk dëshirojnë që tokat në territorin e fshatit Dukaj t'u jepen personave të huaj nga jashtë fshatit, as me qira. Në rast se kjo tokë do të jepet me qira, kërkojmë që të kenë përparësi bashkëfshatarët e fshatit Dukaj.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Mos ka aplikuar tek paketa e maleve?

Z.Myrdar Jera: Po është paraqitur një kërkesë nga një person me banim në Vlorë për marrjen e kësaj sipërfaqeje toke. Si banorë të fshatit Dukaj, ne nuk jemi dakord me dhënien e kësaj toke këtij personi.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Nëse personi ka paraqitur kërkesë për paketen e maleve, ankesa lidhur me kërkesën duhet të ishte paraqitur më parë pranë Bashkisë.

Z.Myrdar Jera: Kur morëm dijeni për këtë kërkesë, ne paraqitëm kërkesën tonë pranë Bashkisë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Paketa e Maleve është miratuar nga Këshilli Bashkiak. Në kuadër të kësaj pakete, mund të paraqitet kërkesë për një sipërfaqe toke të caktuar, në rastet kur një qytetar e ka pasur atë sipërfaqe me qira për një periudhë të gjatë dhe nuk ka pasur ankesa.

Z.Myrdar Jera: Kjo sipërfaqe toke nuk ka qenë e dhënë me qira, për këtë arsye, ne kërkojmë që ajo të mos i jepet me qira këtij personi.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Nga sot e në vazhdim për sipërfaqen e tokës në vendin e quajtur Sheshi i Fierit, Këshilli Bashkiak nuk do të miratojë dhënien e tokës me qira pa u marrë më parë mendimi i banorëve të fshatit. Në rast se do të paraqitet një kërkesë për dhënien me qira të kësaj sipërfaqeje, do të zhvillohet konsultim me komunitetin në fshat.Sa i përket kërkesës së paraqitur

nga banorët e Dukajt, ajo do t'i përcillet Bashkisë për shqyrtim dhe ndjekje sipas kompetencave dhe procedurave përkatëse.

Z.Myrdar Jera: Në fshatin Dukaj është dhënë një sipërfaqe prej rreth 5 dynymësh pa dijeninë dhe pa u konsultuar me banorët e fshatit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Vazhdojmë për shqyrtim kërkes-ankesa te qytetrëve të depozituara pranë Këshillit Bashkiak, si më poshtë:

1. **Kërkesë z. Imer Elezi**, banor i fshatit Lab Martalloz, njësia administrative Lopës, i cili kërkon mbështetje financiare për arsye shëndetësore. Kjo kërkesë t'i përcillet Bashkisë, zyrës përkatëse për shqyrtim.
2. **Kërkesë znj. Leonora Feimi**, banore e Njësisë Administrative Kurvelesh, fshati Progonat, e cila kërkon ndërhyrje për hapjen e rrugës për në banesë, pasi rruga është e bllokuar. Kjo kërkesë t'i përcillet zyrës përkatëse në Bashki për verifikim dhe marrjen e masave të nevojshme.
3. **Kërkesë znj. Razie Çela**, banore e fshatit Hormovë, Njësia Administrative Qendër, e cila kërkon ndihmë financiare për arsye shëndetësore. Kjo kërkesë t'i përcillet Bashkisë për shqyrtim.
4. **Kërkesë z. Rushit Mullara**, banor i fshatit Dragot, Njësia Administrative Qendër, i cili kërkon mbështetje për rikonstruksionin e banesës. Kjo kërkesë t'i përcillet zyrës përkatëse në Bashki për shqyrtim dhe ndjekje.
5. **Kërkesë e znj.Eranda Beshika**, banaore e qytetit Tepelenë, e cila kërkon ndihmë financiare për fëmijët e saj, duke qënë nënë e vetme pasi bashkëshorti i saj ka ndërruar jetë. Kjo kërkesë t'i përcillet Bashkisë për shqyrtim.

Znj.Esmeralda Bishani: Kemi shqetësimin lidhur me praninë e qenve endacakë në qytet dhe kërkoj që nga Bashkia të merren masat e nevojshme për trajtimin e kësaj problematike.

Z.Latif Kacaj: Kam një kërkesë në lidhje me një familje në nevojë, ku kryefamiljarit i ka ndërruar jetë bashkëshortja dhe ka dy fëmijët. Kërkoj që kjo familje të mbështetet dhe të ndihmohet nga Bashkia.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Familja duhet të paraqesë një kërkesë pranë Bashkisë, në mënyrë që rasti të shqyrtohet, dhe të vlerësohet mundësia e mbështetjes.

Z.Besnik Maça: Është vendosur një tabele pranë Bashkisë, ku thuhet se hapësira është vetëm për automjetet e Bashkisë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Tabela është vendosur nga Bashkia për shkak se automjetet e parkuara në atë hapësirë bllokojnë kalimin dhe pengojnë lëvizjen e automjeteve të Bashkisë.

Z.Besnik Maça: Ajo është rrugë kryesore dhe se hapësira nuk duhet të kufizohet vetëm për përdorim nga automjetet e Bashkisë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Edhe pa vendosjen e tabelës, parkimi në trotuar përbën shkelje dhe mund të ndëshkohet me gjobë nga Policia.

Z.Besnik Maça: Nuk mund të vendoset një tabelë e tillë në një rrugë kryesore, duke përcaktuar përdorimin e hapësirës vetëm për automjetet e Bashkisë.

Znj.Matilda Çela Tabela duhet të hiqet, pasi qytetarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë. Nuk mund të përcaktohet një hapësirë parkimi vetëm për punonjësit e Bashkisë. Nëse kjo hapësirë përdoret si parkim, ajo duhet të jetë e barabartë për të gjithë qytetarët. Të heqet tabela.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Duke mos pasur çështje të tjera për diskutim, deklaroj të mbyllur mbledhjen. Ju faleminderit!

Mbyllet mbledhja e Këshillit Bashkiak në orën 12:17.

SEKRETARE E KËSHILLIT
Valbona ÇELA

KRYETAR I KËSHILLIT
Arben GUMENI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA TEPELENË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCA E KËSHILLTARËVE
MBLEDHJA E RADHËS E KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË
Datë: 30.09.2026

Në mbledhjen e zhvilluar më datë 30.09.2026 morën pjesë këshilltarët si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Nënëshkrimi
1	ARBEN GUMENI	
2	MATILDA ÇELA	
3	DINO DELIMI	
4	MIRELA VARFI	
5	MJAFTONI ZERAJ	
6	ESMERALDA BISHANI	
	BESNIK MAÇA	
8	LATIF KAÇAJ	
9	MIFTAR META	
10	ILIR HASKA	
11	MARSELA BALILI	
12	MARIOS JORGO	
13	DITAR HODAJ	
14	VLADIMIR BAKIAJ	
15	VLADIMIR GJONÇA	